



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:119456

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05814743

PA1.nr.573/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Abdullah Ahmeti - anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh. H. , nga fshati N, tani me vendbanim në P, për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 187 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit Xh. H. - avokat K. K. dhe ankesës së të akuzuarit Xh. H. , të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.1868/20, datë 22.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 06.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me rastin e ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit Xh. H. - avokat K. K. dhe ankesës së të akuzuarit Xh. H. e sipas detyrës zyrtare, për të akuzuarin Xh. H. , **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1868/20, datë 22.01.2024, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës ndaj të akuzuarit Xh. H. , për veprën penale Sulmi, nga neni 187 par.1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë e refuzon akuzën në kuptim të nenit 362 par.1 nën par.1.3 të KPPK-së, lidhur me nenin 107 par.8 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II. Ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit dhe ajo e të akuzuarit janë jo lëndore.

III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin, P.nr.1868/20, datë 22.01.2024, të akuzuarin Xh. H. , për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1000 € (njëmijë euro) të cilin dënim i akuzuari është obliguar t'a paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, Gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke ua llogaritur 1 (një) ditë burgim, me 20 euro të gjobës. Është detyruar i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë shumë prej 60 (gjashtëdhjetë) euro, dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave shumë

prej 20 euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim. Pala e dëmtuar Arben Gashi, kërkesë pasurore juridike nuk ka paraqitur.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh. H. - avokat K. K. , për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet i akuzuari të lirohet nga akuza ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosije.

I akuzuari Xh. H. , për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet i akuzuari të lirohet nga akuza ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosije.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.576/2024, datë 15.04.2024 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.576/2024, datë 30.04.2024 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

-Me rastin e ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit Xh. H. - avokat K. K. dhe ankesës së të akuzuarit Xh. H. , aktgjykimi i shkallës së parë detyrimisht ndryshohet sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën për të cilën janë ushtruar ankesat e sipas detyrës zyrtare, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljet e ligjit penal, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret e drejta në ndjekje penale është parashkruar.

Nga shkresat e lëndës del i akuzuari Xh. H. , është shpallur fajtor për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 187 par.1 të KPRK-së, (i cili ishte në fuqi gjatë kohës kur është kryer vepra penale), për të cilin parashihet dënimi me gjobë ose dënim me burgim deri në 3 (tri) vite. Sipas dispozitës së nenit 106 par.1 nën par 1.5, të KPRK-së (Ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale), për vepër penale të dënueshme me më shumë se 1 (një) vit burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 (tre) vite, nga koha e kryerjes së veprës penale (parashkrimi relativ), ndërsa sipas dispozitës së nenit 107 par.8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Lënda e lartcekur penale në Gjykatën e Apelit ka arritur me datë 08.04.2024, për marrjen e mendimit në Prokurorinë e Apelit lidhur me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit është dorëzuar

me datë 11.04.2024, nga Prokuroria e Apelit me mendim është kthyer me datë 16.04.2024, është dërgua prapë për mendim në Prokurorin e Apelit lidhur me ankesën e të akuzuarit dhe nga Prokuroria e Apelit me mendim është kthyer me datë 03.05.2024, gjyqtarit të çështjes lënda iu është dorëzuar në punë me datë 15.05.2024, 3 (tre) ditë para arritjes së afatit të parashkrimit absolut. Meqenëse mbrojtësi i të akuzuarit dhe vet i akuzuari aktgjykimin e kanë ankimuar për shkak të të gjitha bazave juridike, mes tjerash edhe për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike atëherë domosdoshmërisht është dashur që të caktohet seancë publike konform dispozitës të nenit 390 par. 1 të KPP-së e meqenëse ftesa palëve duhet të iu dorëzohet së paku 8 (tetë) ditë para mbajtjes së seancës publike, në pamundësi të caktimit të seancës publike e pas kalimit të afatit ligjor për parashkrim absolut u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se vepra penale nga i akuzuari është kryer më datë 18.05.2018, kurse afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedhë nga data kur është kryer vepra penale. Në rastin konkret duke pasur parasysh se nga koha e kryerjes së veprës penale, ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, prej kohës së kryerjes së veprës penale e deri në ditën e mbajtjes së seancës me dt. 21.05.2024, kanë kaluar më shumë se 6 (gjashtë) vite, nga këto arsye aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me ç'rast ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit dhe ajo e të akuzuarit janë jo lëndore. Shpenzimet e procedurës penale konform dispozitës së nenit 450 të KPPK-së bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës së nenit 403 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.573/24, më datë 06.06.2024

Zyrtarja ligjore;
Rrezarta Bala

Kryetari i kolegjit
Zyhdi Haziri

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Abdullah Ahmeti